



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

## Raport Konsultativ

Shqyrtimi i shtatë i tarifave të energjisë elektrike

**SHTE7 (2013-2017)**

**Vlerësimi i përkohshëm – Raporti i Detajuar mbi Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes**

### DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është hartuar nga ZRRE për qëllime të pranimit të komenteve eventuale nga palët e interesit. Dokumenti nuk përfaqëson vendim të ZRRE-së.

**8 janar 2013**

## **Përmbajtja**

<b>1</b>	<b>Hyrje</b> .....	<b>2</b>
<b>2</b>	<b>Vlerësimi i përkohshëm i Shpenzimeve të propozuara kapitale të OSSH-së</b> .....	<b>2</b>
2.1	Propozimet e Shpenzimeve kapitale të OSSH-së .....	2
<b>3</b>	<b>Vlerërimi kalimtar i shpenzimeve operative të propozuara nga OSSH</b> .....	<b>4</b>
3.1	Nivelet e stafit .....	4
3.2	Shpenzimet e pagës dhe shpenzimet e ndërlidhura .....	5
3.3	Riparimet dhe mirëmbajtja .....	5
3.4	Shpenzimet e tjera të kontrollueshme operative .....	6
3.5	Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së i propozimeve të shpenzimeve operative të OSSH-së .....	6
<b>4</b>	<b>Vlerësimi i përkohshëm i shpenzimeve kapitale të propozuar nga FPEE</b> .....	<b>6</b>
<b>5</b>	<b>Vlerësimi i përkohshëm i shpenzimeve operative të propozuara nga FPEE</b> .....	<b>7</b>
5.1	Niveli i stafit .....	7
5.2	Shpenzimet e pagës dhe shpenzimet e ndërlidhura .....	7
5.3	Shpenzimet tjera operative të kontrollueshme .....	7
5.4	Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE për propozimet e shpenzimeve operative të FPEE-së .....	8
<b>6</b>	<b>Parametrat tjera rregullative</b> .....	<b>8</b>
6.1	Humbjet e lejuara .....	8
6.2	Faktori i ndarjes së humbjes .....	8
6.3	Faktori i efikasitetit .....	9
6.4	WACC .....	9
<b>7</b>	<b>MAR-et e përkohshme 2013-2017</b> .....	<b>9</b>

## 1 Hyrje

Më 8 qershor 2012 ZRRE-ja paralajmëroi fillimin e Shqyrtimit të shtatë të tarifave të energjisë elektrike (SHTE7), i cili, për herë të parë, do të mundësojë përcaktimin e të hyrave maksimale të lejuara të të licencuarëve për periudhë shumë vjeçare. Sipas ligjit, këto të hyra maksimale të lejuara duhet të jenë të mjaftueshme për të mbuluar kostot e arsyeshme operative dhe kapitale të kryerjes së aktiviteteve të licencuara. Për të përcaktuar nëse të hyrat janë adekuate, ZRRE duhet të vlerësojë me kujdes kostot e parashikuara të të licencuarëve dhe të bindet që propozimet e tyre janë të arsyeshme dhe të qëlluara. Me ligj, të licencuarit janë të obliguar t'i ofrojnë të gjitha të dhënat të cilat ZRRE-së i nevojitetn për këtë analizë. Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH-së) i është kërkuar që të prezantojë aplikacionin e vet ZRRE-së dhe publikut më 3 shtator. Që nga kjo datë, ZRRE ka punuar për së afërmi me kompaninë për të qartësuar aplikacionet fillestare. OSSH-ja ka shënuar përparim domethënës në aplikacionet e të dhënave që nga parashtrimi i tyre fillestar.

Në harmoni me Rregullat e publikuara, ZRRE duhet të përcaktojë dhe të konsultohet lidhur me propozimet e saja për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) që mund t'i mbulojnë të licencuarit gjatë periudhës rregullative, si dhe arsyetimet për këto. Rregullat lejojnë që ZRRE të ndryshojë, fshijë apo të zëvendësojë ndonjë pjesë të propozimeve të të licencuarëve kur veprimet e tilla janë të arsyetuara.

Ky dokument është pjesë përbërëse e këtij Vlerësimi të përkohshëm dhe duhet të lexohet bashkërisht me “Vlerësimin e përkohshëm – Dokumenti i përgjithshëm” të botuar krahas këtij dokumenti dhe shtojcave të tij. Ai është strukturuar si vijon:

Pjesa 2 – Vlerësimi i përkohshëm i Shpenzimeve të propozuara kapitale të OSSH-së

Pjesa 3 – Vlerësimi i përkohshëm i Shpenzimeve të propozuara operative të OSSH-së

Pjesa 4 – MAR-i i përkohshëm 2013-2017

Pjesa 5 – Parametrat e tjerë rregullativ

## 2 Vlerësimi i përkohshëm i Shpenzimeve të propozuara kapitale të OSSH-së

### 2.1 Propozimet e Shpenzimeve kapitale të OSSH-së

Më 19 tetor 2012, ZRRE publikoi një dokument konsultimi (“Vlerësimi fillestar i formularëve të Raportimit të KEK-ut”) ku, ndër të tjera, përvijëzohet kuptimi i parashtresës së OSSH-së deri më sot dhe kërkoi sqarime dhe arsyetime shtesë. ZRRE deklaroi se pa arsyetim të duhur të kostove të OSSH-së si dhe shpjegimeve të mospërputhjeve, ZRRE do t'i konsiderojë disa elemente të kostos së tyre si të paarsyeshme dhe t'i përjashtojë nga MAR-i.


## Vlerësimi i përkohshëm – Raporti i Detajuar për OSSH-në

Aplikacionin përfundimtar i OSSH-së për MAR-it<sup>1</sup> përbëhet nga një listë e projekteve që kapin shumë totale prej €114.1m të cilat duhet të zbatohen gjatë Periudhës Rregullative prej pesë viteve. OSSH planifikon ta shpërndajë në mënyrë të barabartë këtë plan të shpenzimeve kapitale përgjatë çdo Viti Relevant të Periudhës Rregullative, ku investimet do të variojnë prej €22m deri në €23m në vit.

Vlerësimi teknik i shpenzimeve kapitale të OSSH-së sugjeron që plani i investimeve të OSSH-së është në përputhje me Planin Zhvillimor të OSSH-së dhe se shpenzimet kapitale bazohen mbi kërkesat e rrjetit si dhe prioriteteve të OSSH-së. Për më tepër, modeli i Shpenzimeve që kanë të bëjnë me me ngarkesën si dhe Shpenzimeve që nuk kanë të bëjnë me ngarkesën sugjerojnë se nivelet aktuale të shpenzimeve kapitale janë nën nivelet e pritshme, duke marrë parasysh profilin aktual të vjetërsisë së aseteve, madje edhe me supozimet më optimiste lidhur me jetëgjatësinë e aseteve. Prandaj, vlerësimi teknik sugjeron që projektet e propozuara nga OSSH të mos përjashtohen nga MAR.

Aplikacioni i shpenzimeve kapitale të OSSH-së i është nënshtruar një studimi të mëtejshëm rigoroz për të vlerësuar nëse kostot njësi për secilin nga projektet e shpenzimeve të propozuara kapitale të tyre janë në përputhje me krahasues relevantë ndërkombëtarë. Të dhënat nga vlerësimi teknik sugjerojnë që kostot e OSSH-së për njësi janë më të larta se sa ato që priten, në veçanti ato për linjat ajrore (të të gjitha tensioneve) si dhe kabllot 400 V.

ZRRE rrjedhimisht ka përshtatur planin e shpenzimeve kapitale të OSSH-së për të pasqyruar azhustimet e kostos së njësi. Shpenzimet kapitale për OSSH-në të propozuara nga ZRRE arrijnë vlerën prej €99.6m krahasuar me atë të OSSH-së në vlerë prej €114.1m të cilët përfaqësojnë një ulje prej 12.7% për listën e njëjtë të projekteve të shpenzimeve kapitale.



<sup>1</sup> The submission dated 23 November 2012

### 3 Vlerërimi kalimtar i shpenzimeve operative të propozuara nga OSSH

Që nga aplikacioni fillestar për tarifa më 31 gusht, OSSH ka prezantuar shpenzime e tyre operative në një numër të të dhënave të dorëzuara pas takimeve pasuese ndërmjet KEK-ut dhe ZRRE-së. Duhet të ceket që aplikacioni i KEK-ut për shpenzimet e përgjithshme operative (opex) është ulur për €4.4m ndërmjet aplikacionit fillestar dhe atij përfundimtar. Kërkesat e ndryshme të ofruara nga OSSH-ja janë përmbledhur në tabelën vijuese:

Emri i dosjes së parashtrësës	Opex-i total i zyrës kryesore 2013-2017 (Nga fleta punuese Opex-i për HQ1 (HQa))	Opex-i total për OSSH 2013-2017 (Nga Fleta Punuese DS3 Të tjera (OSSH))
Formularet Raportues 2013-2017 (01-09-2012)	59.8	130.1
Formularet Raportues 2013-2017 (14-09-2012)	59.8	130.1
Finale Formularet Raportues (09-11-2012)	59.8	130.1
Finale Formularet Raportues (23-11-2012)	59.8	125.7

ZRRE i ka alokuar kostot për administratën qendrore (HQ) divizioneve të KEK-ut duke përdorur numrat e nëpunësve të KEK-ut si çelës alokimi me proporcione vijuese:


Emri i dosjes së parashtrësës	OSSH	FPEE	Gjenerimi	Minierat
Finale Formularet Raportues (23-11-2012)	16%	16%	22%	45%

Gjatë vlerësimit të arsyeshmërisë së Opex-it të OSSH-së, ZRRE është e mendimit se këto duhet të jenë në përputhje me nivelet e lejuara me SHTE6, përveç nëse ekziston ndonjë arsye e qartë që këto të ndryshohen.

#### 3.1 Nivelet e stafit

ZRRE ka vlerësuar nivelet e stafit të OSSH-së me një analize të treguesve afaristë (benchmark) të kryer nga inxhinierët konsultues të ZRRE-së. ZRRE cek se nevojiten të dhëna të besueshme për të kryer si duhet analizën e treguesve afaristë dhe se kostot e përcaktimit të treguesve afaristë të OSSH-së kundrejt homologëve ndërkombëtarë mund të mos jenë të mundur, duke marrë parasysh informatat mbi trajtimin dhe mbi llogaritë menaxheriale të KEK-ut.

Përkundër kësaj, ZRRE ka analizuar tregues afaristë të nivelit të lartë për stafin sipas njësive të rrjetit, duke qenë se kjo është shtytëse kryesore e kostos së kontrollueshme të Opex-it të OSSH-së. Analiza e treguesve afaristë ka krahasuar nivelet e stafit të OSSH-së së KEK-ut në raport me gjatësinë e rrjetit me kompani të shpërndarjes në Lindjen e mesme dhe ka prezantuar analizën në figurën vijuese:



Të dhënat nga analizat e treguesve afaristë të marrë përsipër sugjerojnë se numri i stafit të OSSH-së krahasuar me gjatësinë e rrjetit është më i lartë se krahasuesit e tjerë ndërkombëtar. SKM ka propozuar që niveli i stafit të mbetet në numrat e vitit 2012, gjatë tërë periudhës dhe ZRRE-ja e konsideron këtë si të qëlluar për qëllime të përcakimit të një lejimi të duhur për kostot e personelit.

### 3.2 Shpenzimet e pagës dhe shpenzimet e ndërlidhura

OSSH parasheh një rritje vjetore në pagën mesatare prej 5% në terma reale. Nuk ka numra gjegjës të stafit pasi që OSSH-ja propozon ngrirjen e numrit të stafit gjatë tërë periudhës rregullative. OSSH-ja sugjeron që kjo bëhet për të rritur kosto për punëtor mbi Indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit (HICP) për periudhën 2008-2011 prej 5.4%, gjë që, në vija të trasha, është në harmoni me Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) të Kosovës.

ZRRE nuk sheh asnjë arsytim për rritjet në terma reale të shpenzimeve të pagave dhe për përcaktimin e MAR-it për periudhën e ardhshme propozon që pagat të mbesin në nivelet e vitit 2012.

### 3.3 Riparimet dhe mirëmbajtja

Pas aplikacioneve fillestare OSSH ka ofruar detaje të vëllimit historik dhe të parashikuar të mirëmbajtjes dhe riparimit, në përgjigje të kërkesës së SKM-së, por nuk ka mundur të ofrojë kostot për njësi për aktivitetet e O&M. KEK-u sqaroi se kjo është për asye se KEK-u nuk bën përcaktim të kostove bazuar në aktivitete.

Parashikimi, ashtu siç është prezantuar, paraqet një rritje prej 4% për çdo vit, nga shpenzimi i lejuar për vitin 2012. Arsyetimi për këtë është i lidhur me rritjen e madhësisë së paraparë të rrjetit të OSSH-së prej 4% çdo vit. Modelimi i SKM-së i shpenzimeve kapitale të rrjetit sygjeron se shpenzimi mesatar

## Vlerësimi i përkohshëm – Raporti i Detajuar për OSSH-në

i ndërlidhur me ngarkesën në rrejt prej €9.2 m është i barazvlershëm me 1.5% rritje vjetore në madhësinë e rrejtit, dhe jo 4% siç është supozuar nga OSSH.

Kostoja për njësi për aktivitetet e R&M (Riparimit dhe Mirëmbajtjes) nuk është dhënë në sistemet aktuale të kontabilitetit të KEK-ut ndërsa informata të tjera të cilat do të lejonin analiza të mëtejme kuantitative të aplikacionit nuk u vënë në dispozicion nga KEK-u. Të dhënat e prezantuara nuk mbështesin një rritje prej 4% në vit. Prandaj, ZRRE propozon që të shpenzimet e kësaj kategorie të rriten për 1.5% në vit për të akomoduar rritjen në madhësinë e aseteve.

### 3.4 Shpenzimet e tjera të kontrollueshme operative

Vlerësimi i ZRRE-së të kategorive të tjera të zbërthyer të OSSH-së për shpenzimet operative mbuloi edhe zërat në vijim:

- Karburantet;
- Shpenzimet e tjera.

KEK-u ka paraparë që këto vlera të rriten nga viti në vit krahasuar me vlerën e vitit 2012 duke lidhur rritjen me rritjet e numrit të konsumatorëve.

ZRRE vë në pah se këto kosto do të varen në masë të madhe nga numri i punëtorve, për dallim nga numri i konsumatorëve. Pasi që OSSH nuk ka paraparë rritje të numrit të stafit në periudhën e ardhshme rregullative, ZRRE vlerëson që niveli për këto kategori të mbetet i njëjtë me atë të vitit 2012.

### 3.5 Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së i propozimeve të shpenzimeve operative të OSSH-së

Për Divizionin e OSSH-së, redukimi i rekomanduar i kostove të kontrollueshme është €10.3m gjatë kësaj periudhe, gjë që përfaqëson 12% të kostove totale të kontrollueshme.

Vlerësimi i përkohshëm i opex-it të kontrollueshëm të OSD-së nga ZRRE	2013 € 000's	2014 € 000's	2015 € 000's	2016 € 000's	2017 € 000's	Totali € 000's
Opex i kontrollueshëm i propozuar nga OSD	15,935	16,689	17,454	18,090	18,799	86,967
Opex-i i kontrollueshëm i propozuar nga ZRRE	15,177	15,250	15,234	15,399	15,476	76,626
Dallimi (€ 000's)	-758	-1,439	-2,220	-2,691	-3,323	-10,341
Dallimi %	-5%	-9%	-13%	-15%	-18%	-12%

## 4 Vlerësimi i përkohshëm i shpenzimeve kapitale të propozuar nga FPEE

Biznesi i FPEE-së (Furnizuesi Publik i Energjisë Elektrike) i KEK-ut nuk është intenziv për nga asetet dhe shpenzimet e propozuara kapitale të Kompanisë nuk janë domethënëse. Shuma e propozuar është në përputhje me nivelet historike të shpenzimeve. SKM ka propozuar që shpenzimet e propozuara të lejohen në tërësi, ndërsa ZRRE ka pranuar këtë rekomandim në dhënien e vlerësimit të vet të përkohshëm. Capex-i i propozuar jepet në tabelën e mëposhtme.

## Vlerësimi i përkohshëm – Raporti i Detajuar për OSSH-në

FPE i KEK-ut – Capex-i i propozuar	Capex-i vjetor (€)
Kompjuterët për departamentin e kujdesit të konsumatorëve	50,000
Furnizimi me printerë për faturim	35,000
Printerët për arkat	40,000
Furnizimi me aparaturë të fotokopjimit	20,000
Automjetet	250,000
<b>Capex-i total vjetor</b>	<b>€ 395,000</b>

## 5 Vlerësimi i përkohshëm i shpenzimeve operative të propozuara nga FPEE

Aplikacioni final i KEK-ut, i datës 23-11-2012, ka përfshirë kërkesën për shpenzime totale operative të FPEE-së prej €528.8 m (përfshirë alokimin për zyren kryesore) dhe është dhënë në Shtojcën B. Lëmitë kryesore të kostove operative të FPEE-së janë:

Opex-i i propozuar nga FPEE	2013-2017 €m
Shpenzimet e personelit	46.0
Blerjet e energjisë elektrike dhe ngarkesat për transmission	454.0
Amortizimi	6.6
Mirëmbajtja dhe riparimi	3.3
Kostot tjera	19.0
<b>Totali</b>	<b>528.9</b>

### 5.1 Niveli i stafit

Parashtrimi i propozuar i kompanisë propozon ruajtjen e nivelit të FPEE-së në nivelin aktual prej 1,380. Në periudhën pesë-vjeçare rregullative parashihen 32 pensionime të cilat nuk janë marrë parasysh në parashikimin e numrave të stafit.

Rritja e numrit të konsumatorëve çdo vit (~3%) duhet të ndikojë si një shtytës për rritjen e numrit të stafit të FPEE-së. KEK-u planifikon që të fiksojë numrin e punëtorëve në nivelin aktual, prandaj ka një efikasitet të nënkuptuar prej 3%.

### 5.2 Shpenzimet e pagës dhe shpenzimet e ndërlidhura

Duke marrë parasysh nivelet e stafit të FPEE-së, ZRRE, në përcaktimin e lejitimit për shpenzimet e pagës, propozon që shpenzimet në këtë kategori të mbesin në nivelet e vitit 2012.

### 5.3 Shpenzimet tjera operative të kontrollueshme

Aplikacioni për “Shpenzimet tjera operative të kontrollueshme” të FPEE-së me zërat vijuese, janë dhënë më poshtë së bashku me rritjen e propozuar vjetore të shpenzimeve në përqindje:



## Vlerësimi i përkohshëm – Raporti i Detajuar për OSSH-në

Kategoria	2012	2013	2014	2015	2016	2017
	€ 000's	€ 000's	€ 000's	€ 000's	€ 000's	€ 000's
Karburanit	540	567	591	611	631	648
Riparimet dhe mirëmbajtja (R&M)	282	296	309	319	330	338
Materialët dhe furnizimet	310	326	339	351	363	372
Shpenzimet tjera	1,640	1,723	1,796	1,856	1,918	1,968
Rritja vjetore në %	N/A	1.055	1.042	1.034	1.033	1.016

Ngjashëm me qasjen për OSSH-në është vërejtur që për këto zëra KEK-u ka paraparë rritje vjetore që sipas KEK-ut shtyhet nga rritja e numrit të konsumatorëve.

Ashtu si me kostot tjera të kontrollueshme, ZRRE pajtohet me SKM-në se këto kosto varen në masë të madhe nga numri i stafit dhe jo numri i konsumatorëve. Pasi që FPEE e KEK-ut nuk parasheh rritje të numrit të stafit në periudhën e ardhshme pesë-vjeçare të TSHV-së, ZRRE propozon që këto lejesa të mbesin në nivelet e vitit 2012.

### 5.4 Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE për propozimet e shpenzimeve operative të FPEE-së

KEK-u parasheh që këto kostot të rriten krahas rritjes së numrit të konsumatorëve.

Kostot e parashtruara të KEK-ut për çdo vit, krahas rritjes së propozuar në përqindje të koston janë dhënë në tabelën në vijim:

Për veprimtarinë e FPE-së së KEK-ut, ulja e rekomanduar në kostot e kontrollueshme gjatë periudhës është €9.7m, që përfaqëson rreth 14% të koston totale të kontrollueshme.

Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së për Opex-in e kontrollueshëm të FPE-së	2013	2014	2015	2016	2017	Total
	€ 000's	€ 000's	€ 000's	€ 000's	€ 000's	€ 000's
Opex-i i kontrollueshëm i propozuar i FPE-së	13,044	13,699	14,355	14,875	15,481	71,454
Opex-i i kontrollueshëm i propozuar i ZRRE-së	12,337	12,337	12,337	12,337	12,337	61,684
Dallimi (€ 000's)	-707	-1,362	-2,018	-2,538	-3,114	-9,770
Dallimi %	-5%	-10%	-14%	-17%	-20%	-14%

## 6 Parametrat tjera rregullative

### 6.1 Humbjet e lejuara

ZRRE ka përcaktuar nivelin e humbjeve që mund të mbulohen përmes tarifave të rregulluara bazuar në Vendimin e ZRRE-së 399 të 6 shkurtit 2012. Kështu ZRRE ka ulur nivelin e humbjeve të lejuara në 2011 për 3% (pika të përqindjes), në 27.4% .

### 6.2 Faktori i ndarjes së humbjes

Faktori i ndarjes së humbjeve është përcaktuar në përputhje me Vendimin e ZRRE-së Nr. 399 të 6 shkurtit 2012 në 0%. Implikimi i kësaj është që çfarëdo përfitime apo humbje të mundshme të cilat

## Vlerësimi i përkohshëm – Raporti i Detajuar për OSSH-në

mund të fitohen nga ulja e humbjeve për më shumë apo më pak se sa caku i ZRRE-së do të barten nga OSSH.

### 6.3 Faktori i efikasitetit

Faktori i efikasitetit për tre vitet e para të Periudhës Rregullative është përcaktuar me Vendimin Nr. 399 të ZRRE-së të 6 shkurtit 2012 në 0%. ZRRE propozon që faktori i efikasitetit për dy vitet e fundit të Periudhës Rregullative të përcaktohet në 5% në vit sipas diskutimit të dhënë në Dokumentin e Përgjithshëm.

### 6.4 WACC

Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (WACC) për OSSH-në është përcaktuar në përputhje me Vendimin e ZRRE-së 399 të 6 shkurtit 2012. Sipas këtij Vendimi, WACC e aplikueshme për OSSH për Periudhën e ardhshme rregullative duhet të jetë 12% (reale, para-tatimit).

## 7 MAR-et e përkohshme 2013-2017

MAR-i fillestar për OSSH-në, që përfshin kostot O&M, Kostot e zhvlerësimit, të kthimit të lejuar dhe të humbjeve është përmbledhur në tabelën në vijim:

Vlerësimi i përkohshëm i MAR për OSSH-në	2013	2014	2015	2016	2017	Totali
	€m	€m	€m	€m	€m	€m
Totali	73.9	72.8	71.9	69.5	69.2	357.3

MAR-i fillestar për FPEE-në që përfshin kostot O&M, kostot e zhvlerësimit, marzhën me pakicë, kapitalin punues dhe nivelin e lejuar të borxhit të keq është përmbledhur në tabelën në vijim:

Vlerësimi fillestar i MAR-it të FPEE-së	2013	2014	2015	2016	2017	Totali
	€m	€m	€m	€m	€m	€m
Totali	32.3	32.5	30.5	30.9	32.2	158.5